



Nga: Bardhyl MAHMUTI



KPK-ja NOMINON ZEJNULLAH GASHIN PËR KRYEPROKUROR TË SHTETIT, SHOQËRIA CIVILE KËRKON DEKRETIMIN PA VONESË

FAQE 4-5



Pas votimit të mbajtur të hënën në Këshillin Prokurorial të Kosovës, emri i Zejnullah Gashit i

është përcjellë Presidencës për emërim, ndërsa organizatat e shoqërisë civile e kanë vlerësuar

procesin të rregullt dhe kanë bërë thirrje që ai të përmbyllet sa më shpejt

GJERMANI DIRK SCHUBEL EMËROHET PËRFAQËSUES I POSAÇËM I BE-së NË KOSOVË

F. 3



SHITËSIT ONLINE NË SHËNJESTËR TË MASHTRUESVE

F. 4-5



AKTUALE



'SHBA PO MERR KONTROLLIN E NGUSHTICËS SË HORMUZIT', TRUMPI: DO TË PAGUHEMI QË TA RUAJMË ATË

F. 2

KOMANDANTI I FSK-SË TAKON PËRFAQËSUESIT GJERMANË, NË FOKUS BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E SIGURISË

F. 7

MBI 300 MIJË TURISTË BRENDA PESË MUAJVE NË KOSOVË

F. 7

EKONOMI



INFLACIONI NË KOSOVË ARRIN 6 PËR QIND NË QERSHOR

F. 8

ODA EKONOMIKE AMERIKANE KËRKON QË GAZI AMERIKAN TË JETË PRIORITET I INSTITUCIONEVE TË REJA

F. 8

SPORT



NGA FUSHAT ME BALTË TE SKENA MË E MADHE E BOTËS: 20 YJET E ANGLISË QË SHKRUAN HISTORINË NGA LIGAT E ULËTA

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

“SHBA PO MERR KONTROLLIN E NGUSHTICËS SË HORMUZIT”, TRUMPI: DO TË PAGUHEMI QË TA RUAJMË ATË

UASHINGTON, 13 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po marrin kontrollin e Ngushticës së Hormuzit dhe se Uashingtoni do të paguhet për garantimin e sigurisë në një nga rrugët më të rëndësishme të transportit detar në botë. Në një intervistë për “Fox News”, Trumpi u shpreh se ShBA mund ta marrë rolin e mbrojtjes së ngushticës. “Shtetet e Bashkuara ndoshta do ta drejtojnë Ngushticën e Hormuzit. Nëse e drejtojmë ne, do të paguhemi. Do të bëhemi roje të Ngushticës dhe

do të paguhemi për ta ruajtur atë”, ka deklaruar ai, duke shtuar se “Shtetet e Bashkuara po marrin kontrollin e Ngushticës”. Deklarata vjen në një kohë kur tensionet mes ShBA-së dhe Iranit janë përshkallëzuar ndjeshëm. Sipas “Axios”, forcat amerikane kanë ndërmarrë një valë të re sulmesh ndaj objektivave iraniane. Komanda Qendrore e ShBA-së (CENTCOM) njoftoi se janë goditur dhjetëra objektiva në disa zona me municione të drejtuara me precizitet, me synim për ta dobësuar aftësinë e Iranit për të kryer sulme ndaj

trafikut detar në Ngushticën e Hormuzit. Operacioni amerikan erdhi si kundërpërgjigje ndaj një rakete të lëshuar nga Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) kundër një anijeje tregtare si dhe pas kërcënimeve të Teheranit për mbylljen e Ngushticës së Hormuzit. Në reagim ndaj sulmeve amerikane, forcat e IRGC-së kanë goditur baza ushtarake amerikane në Jordani, Kuvajt dhe Bahrein, duke rritur frikën për një përshkallëzim të mëtejshëm të konfliktit në Lindjen e Mesme.



ZELENSKY NJOFTON PËR ZËVENDËSIMIN E KRYEMINISTRES UKRAINASE

KIEV, 13 KORRIK - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, njoftoi se synon ta zëvendësojë kryeministren Yulia Svyrydenko si pjesë të një riorganizimi më të gjerë të qeverisë, duke thënë se ndryshimet janë të nevojshme për zbatimin e një strategjie të përditësuar politike. Në një postim në “Telegram”, Zelensky e falënderoi Svyrydenkon për punën e saj si kryeministre e Ukrainës dhe tha se i ka ofruar një detyrë të re, që ka të bëjë me raportet me një nga partnerët kyç ndërkombëtarë të Ukrainës. Ai nuk tregoi se për cilin shtet bëhet fjalë dhe nuk dha hollësi të tjera për rolin e propozuar. “Pres që, së bashku me deputetët, t’i bëjmë ndryshimet e nevojshme në Qeverinë e



Ukrainës”, shkroi Zelensky. Presidenti tha se riorganizimi synon ta rifreskojë përbërjen e Kabinetit të Ministrave dhe se përgjegjësitë për fushat kyçe të

politikës së jashtme do t’u besohen zyrtarëve me përvojën përkatëse. Ai njoftoi edhe për ndryshime në drejtimin e disa agjencive të

zbatimit të ligjit, por nuk specifikoi se cilët zyrtarë do të preken. Svyrydenko më pas shkroi në X se me Zelenskyn kanë diskutuar për ndryshimet e planifikuara në qeveri dhe për “hapat e ardhshëm”. Sipas ligjit ukrainas, dorëheqja e kryeministrit duhet të miratohet nga Parlamenti. Nëse deputetët votojnë për ta pranuar atë, i gjithë kabineti qeverisës është i detyruar të japë dorëheqje, pas së cilës duhet të formohet dhe të votohet një ekzekutiv i ri. Para se të bëhej kryeministre në korrik të vitit 2025, Svyrydenko shërbeu si zëvendëskryeministre e parë dhe ministre e Ekonomisë, ku pati rol udhëheqës në politikën ekonomike të Ukrainës dhe në

negociatat me partnerët ndërkombëtarë. Më herët gjatë këtij vit ajo nënshkroi në emër të qeverisë ukrainase marrëveshjen ShBA - Ukrainë për mineralet, pas disa muajsh negociatash mes Kievit dhe Uashingtonit. Emërimi i Svyrydenkos vitin e kaluar u bë në kuadër të një riorganizimi të gjerë të qeverisë, që ishte riorganizimi më i madh që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Gjatë riorganizimit u zëvendësuan kryeministri dhe disa ministra. Zelensky nuk përmendi ndonjë emër si pasardhës i Svyrydenkos dhe as nuk dha ndonjë afat kohor për riorganizimin, veç tha se ai do ta kërkojë miratimin e Parlamentit.

DHJETËRA PERSONA HUMBIN JETËN NGA ZJARRI NË NJË LOKAL NË BANGKOK

BANGKOK, 13 KORRIK - Së paku 27 persona humbën jetën nga një zjarr që përfshiu një lokal nate në kryeqytetin e Tajlandës, Bangkok, tha të hënën kryeministri Anutin Charnvirakul, pasi vizitoi vendin e ngjarjes. Zjarri shpërtheu të dielën vonë në lokalin Rong Beer Na Ladprao, në distriktin verior Ladprao të Bangkokut. Sipas gazetës “Bangkok Post”, 63 persona u lënduan - prej tyre 22 në gjendje të rëndë. Pamjet televizive treguan flakët duke përfshirë lokalin, ndërsa zjarrfikësit arritën t’i vinin nën kontroll pas rreth 45

minutash. Shkaku i zjarrit nuk dihet ende. Guvernatori i Bangkokut, Chadchart Sittipunt, tha se hetuesit po shqyrtojnë nëse daljet emergjente kanë qenë të bllokuara dhe nëse lokali i kishte përmbushur standardet e sigurisë kundër zjarrit. Sipas tij, zjarri u përhap me shpejtësi për shkak të materialeve të përdorura në tavan dhe dekor. Besohet se edhe tymi toksik ndikoi në numrin e lartë të viktimave. Të lënduarit u dërguan në 16 spitale në Bangkok. Transmetuesi publik Thai PBS,

duke cituar ekipet e shpëtimit, raportoi se numri i viktimave kishte arritur në së paku 30. Autoritetet identifikuan deri në atë kohë 17 gra dhe tetë burra. Lokali ndodhet pranë Tregut Chatuchak, një nga atraksionet më të njohura turistike në Bangkok. Ende nuk dihet nëse mes viktimave ka shtetas të huaj. Policia e rrethoi zonën dhe nisi hetime për ta zbuluar shkakun e zjarrit. Familjeve të viktimave iu kërkua të kontaktojnë autoritetet dhe të japin mostra të ADN-së për të ndihmuar në identifikimin e tyre.



KPK-JA NOMINON ZEJNULLAH GASHIN PËR KRYEPROKUROR TË SHTETIT, SHOQËRIA CIVILE KËRKON DEKRETIMIN PA VONESË



Pas votimit të mbajtur të hënën në Këshillin Prokurorial të Kosovës, emri i Zejnullah Gashit i është përcjellë Presidencës për emërim, ndërsa organizatat e shoqërisë civile e kanë vlerësuar procesin të rregullt dhe kanë bërë thirrje që ai të përmbillet sa më shpejt

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 KORRIK - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), nën udhëheqjen e kryesuesit Arian Gashi, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën është shqyrtuar ecuria e procedurës për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe është zhvilluar procesi i votimit për nominimin e kandidatit që do t'i propozohet për emërim ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Arian Gashi, me këtë rast njoftoi se brenda afatit ligjor të përcaktuar me konkurs janë pranuar pesë aplikacione, përkatësisht nga kandidatët: Atdhe Dema, Naim Abazi, Rafet Halimi, Shqipdon Fazliu dhe Zejnullah Gashi, si dhe bëri me dije se pas shqyrtimit

të aplikacioneve nga Sekretariati i KPK-së, është konstatuar se të gjithë kandidatët kanë përmbushur kushtet e parapara për aplikim. "Kandidatët i janë nënshtruar procesit të intervistimit dhe vlerësimit nga paneli vlerësues, ndërsa rezultatet janë përllogaritur dhe publikuar në pajtim me procedurat e konkursit. Kandidatët kanë pranuar edhe kopjet e vlerësimit përfundimtar nga të gjithë anëtarët e panelit vlerësues dhe kanë pasur të drejtën e ushtrimit të ankesës deri më 7 korrik 2026", theksoi Gashi.

Pas shqyrtimit të Raporti final të Panelit Vlerësues, procesi i votimit për nominimin e Kryeprokurorit të Shtetit është zhvilluar me votim të fshehtë. Në këtë votim nuk mori pjesë anëtar i Këshillit, Milot Krasniqi, i cili deklaroi se abstenon nga pjesëmarrja në votim.

Pas përfundimit të votimit,

Kryesuesi i KPK-së konstatoi se kandidati Zejnullah Gashi ka marrë pesë vota, ndërsa kandidati Rafet Halimi një votë.

Në përputhje me rezultatin e votimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nominuar Zejnullah Gashin për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe emri i tij do t'i propozohet ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës për emërim në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi.

Pas takimit të mbajtur të hënën, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka dorëzuar edhe zyrtarisht në Presidencën e Republikës së Kosovës nominimin për Zejnullah Gashi për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Nominimi i është përcjellë ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, së bashku me dokumentacionin e plotë që ka shoqëruar tërë procesin e përzgjedhjes që nga hapja e procedurës e deri te vendimmarrja përfundimtare e KPK-së.

Me dorëzimin e nominimit dhe dokumentacionit përkatës, procedura kalon në fazën e trajtimit nga Presidenca,

ndërsa hapat e mëtejshëm do të zhvillohen në përputhje me kompetencat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

KDI, IKD dhe Lëvizja FOL: Të dekretohet pa vonesë Kryeprokurori i ri i Shtetit

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Lëvizja FOL mirëpresin vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, duke shënuar përfundimin e një procesi të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë. "Gjatë gjithë këtij procesi, organizatat tona kanë monitoruar nga afër zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes. Bazuar në monitorimin e realizuar, vlerësojmë se procesi është zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore, me transparencë, me trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe me respektim të parimeve të meritës. Në secilën fazë, kandidatëve u është garantuar mundësia e barabartë për të prezantuar vizionin e tyre dhe për t'iu nënshtruar një vlerësimi të

njëjtë. Në këtë fazë, mbetet që ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës apo Presidenti i ri, ta ushtrojë kompetencën e saj kushtetuese dhe ta dekretojë Kryeprokurorin e Shtetit, duke e përmbyllur pa vonesa këtë proces. Njëkohësisht ta fuqizojë zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokuror legjitim. Organizatat tona bëjnë thirrje që ky proces të përmbillet në frymën e Kushtetutës dhe ligjit, duke i dhënë fund një periudhe mbi 4 vjeçare, gjatë së cilës sistemi prokurorial ka funksionuar me ushtrues detyre", thuhet në komunikatën e KDI-së, IKD-së dhe Lëvizjes FOL.

Këto organizata konsiderojnë se emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit është me rëndësi të veçantë për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit prokurorial, forcimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. KDI, IKD dhe Lëvizja FOL kanë theksuar se do të vazhdojnë t'i monitorojnë zhvillimet në sistemin e drejtësisë dhe të kontribuojnë për procese të bazuara në ligj, integritet, transparencë dhe meritokraci.

Haxhiu priti në takim lamtumirës ambasadorin belg Grégoire Cuvelier

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur në një takim lamtumirës ambasadorin e Belgjikës në

Kosovë, Grégoire Cuvelier, me rastin e përfundimit të mandatit të tij diplomatik. Haxhiu e falënderoi ambasadorin Cuvelier për kontributin në forcimin e

marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Belgjikës, për dialogun e hapur me institucionet e Kosovës si dhe për mbështetjen e vazhdueshme të Belgjikës

ndaj vendit. Ajo i uroi ambasadorit suksese në angazhimet e tij të ardhshme, duke theksuar se ai do të jetë gjithmonë i mirëpritur në Kosovë.





SHITËSIT ONLINE NË SHËNJESTËR TË MASHTRUESVE

Mashtrulesit po shfrytëzojnë platformat e shitblerjes online në Kosovë duke u paraqitur si blerës dhe duke i drejtuar shitësit në faqe të rreme për t'ua vjedhur të dhënat bankare. Ekspertët paralajmërojnë se këto skema po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara dhe kërkojnë hetime më serioze, bashkëpunim institucional dhe ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve. Qytetarët këshillohen të mos klikojnë në vegëza të dyshimta dhe, në rast mashtrimi, ta kontaktojnë menjëherë bankën dhe policinë

PRISHTINË, 13 KORRIK - Vetëm disa minuta pasi një qytetar nga Prishtina publikoi një shpallje për shitje në platformën online MerrJep, atë e kontaktoi “blerësja” e parë. Ajo u interesua nëse produkti ishte ende në shitje dhe tha se pagesën mund ta kryente online përmes platformës ku e kishte parë shpalljen. Në linkun përmes të cilit, sipas saj, ishte kryer pagesa dhe nevojitej vetëm konfirmimi, shitësit i kërkohej ta verifikonte kartelën bankare dhe ta vendoste shumën e saktë që kishte në llogari. Kur ato informacione nuk iu ofruan, “blerësja” u zhduk.

Profili në Viber, nga i cili u kontaktua qytetari, mbante një emër femre shqiptare dhe kishte fotografi të një gruaje, ndërsa numri i telefonit ishte me

prefiks të Kroacisë. Radio Evropa e Lirë nuk mundi ta verifikonte identitetin e personit që qëndron pas atij profili. REL-i provoi ta kontaktonte numrin nga i cili ishte kontaktuar qytetari edhe përmes Viber-it. Personi pas këtij numri, fillimisht, konfirmoi se kishte “blerë” diçka përmes MerrJep-it, por komunikimi u ndërpre pasi REL-i u paraqit dhe kërkoi sqarime lidhur me rastin. Thirrjet dhe mesazhet e mëvonshme nuk morën përgjigje.

Çfarë thotë MerrJep?

MerrJep nuk ofron shërbime të tilla të pagesës, ndërsa ky qytetar nga Prishtina nuk është

përdoruesi i vetëm që është përballur me një situatë të tillë, thanë nga kjo platformë për Radion Evropa e Lirë. “MerrJep nuk ofron asnjë shërbim pagese, ndërmjetësimi, dorëzimi apo konfirmimi pagese që kërkon nga përdoruesit të klikojnë në vegëza të jashtme ose të japin të dhëna bankare apo të kartelës”, thuhet në përgjigje. “Çdo mesazh që kërkon një informacion të tillë është mashtrim dhe nuk ka lidhje me MerrJep-in”.

Sipas platformës, mashtrulesit monitorojnë shpalljet e reja dhe kontaktojnë shitësit përmes Viber-it ose WhatsApp-it, duke u paraqitur si blerës. Më pas, i drejtojnë në faqe të rreme që imitojnë MerrJep-in ose shërbime pagesash, me synimin për t'ua vjedhur të dhënat financiare.

Në përgjigje, po ashtu, thuhet se nuk mund të spekulojnë se kush qëndron pas këtyre skemave, pasi kjo u takon autoriteteve hetimore.

Sipas platformës, bëhet fjalë për një trend ndërkombëtar të “phishing”-ut, ku keqpërdoren emrat e platformave të besueshme për të mashtruar përdoruesit dhe për t'ua marrë të dhënat bankare apo personale.

Platforma tha se ka pranuar raportime për raste të tilla dhe se, sa herë që identifikon

informacione të dobishme, i ndan ato me Policinë dhe njësitë për krime kibernetike, në përputhje me ligjet për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave. Megjithatë, shtoi se nuk njoftohet për rezultatin përfundimtar të hetimeve, pasi ato zhvillohen nga autoritetet kompetente.

Si funksionojnë këto skema?

Kujtim Kryeziu, drejtor ekzekutiv në kompaninë e sigurisë kibernetike Sentry, thotë se këto mashtrime janë “shumë të rrezikshme”, sepse synojnë faktorin njerëzor dhe jo domosdoshmërisht dobësitë teknike. “Sulmuesit përdorin teknika të inxhinierisë sociale për t'i bindur viktimat që vetë të japin kredencialet bankare, kodet e konfirmimit ose të autorizojnë pagesa”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Eksperti ndërkombëtar i sigurisë kibernetike, George Papariga, anëtar i bordit në Institutin për Hulumtime të Luftës Kibernetike dhe drejtor ekzekutiv i kompanisë BugStream, thotë se skema të tilla zakonisht nisin duke e zhvendosur komunikimin nga platforma zyrtare në aplikacione si Viber, WhatsApp apo Telegram.

Më pas, viktimës i dërgohet një link që paraqitet si konfirmim pagese, organizim dërgese apo rimbursim. “[Por], në realitet, linku çon në një faqe phishing-u, e krijuar për të imituar një shërbim legjitim dhe për të mbledhur të dhënat bankare apo financiare të viktimës”, thotë Papariga për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, rreziku kryesor është se kriminelët nuk kanë nevojë të sulmojnë bankat apo platformat online. Në vend të kësaj, ata manipulojnë përdoruesit që vetë t'ua japin të dhënat e kartelës, kodet njëpërdorimëshe të verifikimit, fjalëkalimet e bankimit online dhe informacione të tjera të ndjeshme financiare.

Institucionet japin pak hollësi për hetimet

Policia e Kosovës nuk ofron hollësi lidhur me rastet që përfshijnë përdorimin e emrit të MerrJep-it apo të platformave të tjera online.

Ky institucion nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it lidhur me hetimet e zhvilluara, dyshimet eventuale apo personat e intervistuar. “Çdo rast që raportohet në polici dhe ka elemente të ndonjë vepr penale, në koordinim me organet e drejtësisë,

GJERMANI DIRK SCHUBEL EMËROHET PËRFAQËSUES I POSAÇËM I BE-SË NË KOSOVË

PRISHTINË, 13 KORRIK - Këshilli i Bashkimit Evropian emëroi diplomatin gjerman Dirk Schubel përfaqësues i ri i posaçëm të BE-së për Kosovën. Ai do ta marrë detyrën më 1 shtator 2026, me mandat fillestar dyvjeçar, duke pasuar estonezin Aivo Orav.

Schubel është diplomat me përvojë të gjatë në Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), Komisionin Evropian dhe Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë.

Aktualisht ai drejton Divizionin për Rusinë në EEAS. Më herët ai ka shërbyer i dërguar i posaçëm i BE-së për Partneritetin Lindor (2022-2024), ndërsa ka qenë shef i Delegacionit të BE-së në Bjellorusi (2019-2022) dhe në Moldavi (2009-2013).

Sipas vendimit të Këshillit të BE-së, mandati i Schubelit do të përqendrohet në promovimin e një Kosove të qëndrueshme, demokratike dhe shumetnike si dhe në mbështetjen e perspektivës evropiane të vendit. Ai do ta monitorojë përparimin në prioritetet politike, ekonomike dhe të sigurisë, do të kontribuojë në forcimin e të drejtave të njeriut, sundim të ligjit dhe mbrojtjes së komuniteteve, si dhe do ta promovojë koordinimin politik të Bashkimit Evropian në Kosovë.

Mandati i tij përfshin, gjithashtu,



ofrimin e udhëzimeve politike për Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe mbështetjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me synim forcimin e stabilitetit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Në dy vjetët e fundit - nga 2024-ta deri në fund të marsit - në këtë funksion ishte Aivo Orav. Në një nga deklaratat e fundit për mediet në Kosovë, Orav tha

se çështja e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë “nuk do të zhduket”. “Dialog do të thotë gjithashtu Asociacion”, tha ai.

Pas largimit të tij, ushtrimin e detyrës e mori përsipër zëvendësshefja e BE-së në Kosovë, Eva Palatova.

Në një shkrim të publikuar javën e kaluar, Palatova tha se Bashkimi Evropian mbetet partneri më i fortë dhe më i

besueshëm i Kosovës si dhe ofruesi më i madh i ndihmës financiare, por theksoi se përgjegjësia për avancimin e së ardhmes evropiane të Kosovës u takon udhëheqësve politikë dhe institucioneve të Kosovës.

Me atë rast, ajo bëri thirrje për formimin e institucioneve të reja të Kosovës, duke thënë se partia fituese - në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje - ka përgjegjësi të veçantë që të angazhohet me partitë e tjera politike për të

arritur kompromis.

Kosova nuk ka institucione të qëndrueshme tash e më shumë se një vit e gjysmë, pasi tri palë zgjedhje të mbajtura brenda kësaj periudhe nuk kanë arritur t'i japin vendit një shumicë funksionale. “Konkurrenca politike është një tipar normal dhe i shëndetshëm i demokracisë. Avancimi i së ardhmes evropiane të Kosovës duhet të jetë objektiv i përbashkët”, shkroi Palatova.

prokurorinë, inicohet për trajtim nga policia”, thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës. Sipas të dhënave të saj, deri në korrik të vitit 2026 janë raportuar 336 raste të mashtrimit, pavarësisht formës së kryerjes - direkt, online apo në forma të tjera.

Për të njëjtën vepër penale, gjatë gjithë vitit 2025 ishin raportuar 349 raste.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi Prokurorinë Speciale, si dhe Prokuroritë Themelore në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë e Prizren, për të pyetur nëse janë duke hetuar raste kur shitës në platforma online, si MerrJep, janë mashtruar nga blerës të rremë dhe nëse është identifikuar ndonjë grup që qëndron pas këtyre skemave. Përgjigje të plotë dha vetëm Prokuroria Themelore në Pejë. Ajo konfirmoi se deri në korrik të vitit 2026 ka pranuar pesë raste që lidhen me mashtrime kompjuterike.

Sipas zëdhënësit Shkodran Nikçi, tri prej tyre janë regjistruar si kallëzime penale kundër kryerësve të panjohur, ndërsa dy të tjera si raporte informuese.

Të gjitha rastet, tha ai, u janë ndarë prokurorëve të shtetit dhe po trajtohen në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Nikçi shtoi se edhe gjatë vitit të kaluar kjo prokurori kishte pranuar dy kallëzime penale për

raste të ngjashme, të cilat vazhdojnë të jenë në hetim. Ndërkaq, Prokuroria Speciale dhe Prokuroritë Themelore në Prishtinë, Mitrovicë e Prizren thanë se, me të dhënat e ofruara nga Radio Evropa e Lirë, nuk mund të identifikonin se për cilat raste bëhej fjalë.

“Mashtrimet online të trajtohen si krime serioze kibernetike”

Rritjen e mashtrimeve online e konfirmon edhe Kujtim Kryeziu nga kompania e sigurisë kibernetike Sentry. Sipas tij, vitet e fundit sulmet jo vetëm janë shtuar, por edhe janë bërë më të sofistikuara. “Sulmuesit kanë në dispozicion mjete gjithnjë e më të avancuara, përfshirë inteligjencën artificiale, e cila u mundëson të krijojnë mesazhe dhe faqe mashtruese shumë më bindëse”, thotë Kryeziu.

Ai vlerëson se këto raste duhet të trajtohen si krime serioze kibernetike, me hetime të shpejta dhe bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve, bankave, platformave online dhe kompanive të telekomunikimit. Po aq të rëndësishme, sipas tij, janë edhe fushatat e ndërgjegjësimit, pasi “qytetarët janë linja e parë e mbrojtjes kundër mashtrimeve të tilla”. I të njëjtit mendim është edhe Papariga. Sipas tij, autoritetet

duhet të kalojnë nga trajtimi i rasteve të izoluar tek identifikimi i rrjeteve të organizuara të mashtrimit, pasi një llogari mashtruese është shpesh vetëm një pjesë e një infrastrukture shumë më të madhe.

Si duhet të reagojnë platformat?

Papariga thotë se platformat online nuk duhet ta lënë gjithë barrën e sigurisë te përdoruesit. Paralajmërimet e tipit “mos klikoni në vegëza të dyshimta” janë të nevojshme, por jo të mjaftueshme, sipas tij. Ai thotë se platformat duhet të përdorin një qasje me disa shtresa mbrojtjeje: të identifikojnë dhe bllokujnë vegëzat e dyshimta, të analizojnë sjelljen e llogarive të reja apo të dyshimta, të vërejnë shpërndarjen masive të mesazheve të ngjashme dhe përpjekjet për t'i zhvendosur përdoruesit shpejt në aplikacione të tjera komunikimi. MerrJep thotë se, kur pranon raportime për raste të dyshimta, heton rastin, largon shpalljet apo llogaritë mashtruese nëse ato ekzistojnë në platformë, bllokoi llogaritë abuzive kur është e mundur, raporton faqet dhe domenet mashtruese tek autoritetet përkatëse dhe bashkëpunon me organet e rendit.

Si të mbrohen qytetarët nga mashtrimet online?

Apelet për kujdes nga mashtrimet online kanë qenë të shpeshta nga Policia e Kosovës këtë vit.

Në apelin e fundit, të bërë në qershor, Policia ka këshilluar që vegëzat e dyshimta, të pranuar përmes mesazheve, të mos hapen, të mos jepen të dhëna personale dhe, në rast të dyshimit për mashtrim, rastet të raportohen në polici.

Në mesin e mashtrimeve për të cilat Policia ka apeluar për kujdes, nuk është përmendur në mënyrë specifike mashtrimi gjatë shitblerjeve në platforma online.

Paralajmërimet e Policisë janë përqendruar kryesisht në mashtrime përmes mesazheve telefonike, kinse nga bankat për rrezik të bllokimit të xhirollogarive bankare, apo për pagesën e gjobave të trafikut. Banka Qendrore e Kosovës dhe pesë banka komerciale, të cilave Radio Evropa e Lirë u dërgoi pyetje lidhur me mashtrimet që përfshijnë pagesat online dhe masat për mbrojtjen e llogarive bankare, nuk u përgjigjën.

MerrJep u rekomandon përdoruesve të mos klikojnë në vegëza të dyshimta të dërguara përmes Viber-it, WhatsApp-it, SMS-it apo email-it dhe të mos japin të dhënat e kartelës

bankare, kredencialet e bankimit online apo kodet njëpërdorimëshe.

Të njëjtën këshillë e jep edhe Papariga. Sipas tij, transaksionet financiare nuk duhet të kryhen përmes vegëzave të dërguara nga persona të panjohur. “Një shitës nuk ka nevojë të vendosë datën e skadimit të kartelës, kodin CVV, fjalëkalimin e bankimit online apo kodin njëpërdorimësh SMS për të pranuar para”, thotë ai.

Nëse dikush bie pre e mashtrimit, Papariga këshillon të kontaktohet menjëherë banka, të bllokohet kartela ose qasja në bankim online, të ruhen provat digjitale dhe rasti të raportohet te Policia.

Edhe Kryeziu paralajmëron që qytetarët të mos u besojnë vegëzave për “konfirmim pagese” dhe kujton se asnjë bankë apo platformë serioze nuk kërkon përmes tyre PIN-in, fjalëkalimet, kodet SMS apo të dhënat e kartelës bankare. Sipas tij, reagimi i shpejtë mund të zvogëlojë dëmet financiare dhe të ndihmojë në identifikimin e autorëve. “Teknologjia vazhdon të evoluojë, por po ashtu evoluojnë edhe metodat e mashtruesve. Prandaj, mbrojtja më e mirë mbetet kombinimi i masave teknike, bashkëpunimit institucional dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve”, përfundon Kryeziu.

DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS NË HAGË



Bardhyl MAHMUTI

(Nëpërmjet znj. Angela Griep, Shefe e Njësisë për Informim dhe Komunikim me Publikun)
Drejtuar gjyqtarëve: Çarls Smith III, Kristof Barte, Genël Metro, Fergal Gejnor

Raamweg 47
2596 HN The Hague
The Netherlands (Holandë)

Të nderuar gjyqtarë të trupit gjykues,

Në këto çaste të 12 korrikut 2026, kur jeni duke punuar rreth përpilimit të vendimit për procesin gjyqësor kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Franca përkujtoi 120-vjetorin e vendimit të Gjykatës së Kasacionit që shpalli pafajësinë e kapitenit Alfred Dreyfus. Si juristë të shkolluar në shtetet perëndimore, ju duhet ta njihni mirë “Çështjen Dreyfus”, jo vetëm si një nga gabimet më të rënda në historinë e proceseve gjyqësore në Europën Perëndimore, por edhe si njëra nga shtyllat themelore të etikës profesionale, ku mbështeten juristët, për të shmangur ndikimet politike, ideologjike apo institucionale në sjelljen e vendimeve.

Për një jurist, “Çështja Dreyfus” i kujton, nga njëra anë, vendimin e gjykatës ushtarake për të dënuar një njeri të pafajshëm mbi bazën e një akuze të sajuar për shkak të përkatësisë së tij etnike (hebraike) dhe, nga ana tjetër, guximin intelektual të disa personaliteteve të shquara franceze.

Edhe sot, në 120-vjetorin e shpalljes së pafajësisë së plotë të Alfred Dreyfosit, kanë mbetur në kujtesën kolektive të juristëve emrat e Émilien Maurel (kryetari i trupit gjykues), Ernest Deleuze,

Joseph Prieur dhe oficerët e tjerë të gjykatës ushtarake që dënuan një të pafajshëm!

Mirëpo në kujtesën kolektive të intelektualëve të shumë fushave të ndryshme të dijes, ka mbetur i skalitur respekti i madh për guximin e nënkolonelit Georges Picquart, shefin e atëhershëm të kundërzbulimit, i cili, pasi zbuloi provat e pafajësisë së Dreyfus-it, vuri të vërtetën dhe ligjin mbi interesin institucional (ushtrinë dhe shtetin). As degradimi, as transferimi dhe as burgosja, nuk e zmbrapsën kolonelin Picquart nga ndriçimi i së vërtetës.

Do të mbetet përjetësisht në kujtesën e njerëzimit, letra publike e Emil Zolës (“J’accuse...” Unë akuzoj), drejtuar Presidentit të Republikës Franceze, Félix Faure, në të cilën ai akuzoi publikisht drejtuesit ushtarakë dhe autoritetet shtetërore se kishin dënuar padrejtësisht Alfred Dreyfus-in, duke fshehur të gjitha provat që dëshmonin për pafajësinë e tij. Shkrimtari i famshëm Emil Zola nuk u tërhoq as pas akuzës për shpifje, as pas dënimit e as pas detyrimit të emigronte në Angli, sepse ai kishte vënë tërë talentin dhe famën e tij intelektuale në shërbim të drejtësisë.

Mund të vazhdoj me qëndrimin e gazetarit Georges Clemenceau, që më vonë u bë Kryetar i Këshillit të Ministrave, filozofin dhe politikanin Jean Jaurès, Anatole France, Marcel Proust dhe shumë personalitete të tjera që rrezikuan veten për të mbrojtur të vërtetën, sepse heshtja e të vërtetës, të bën bashkëfajtor në padrejtësi. Përveç intelektualëve që ngritën zërin kundër procesit të montuar gjyqësor ndaj Alfred Dreyfus-it, në kujtesën e njerëzimit do të mbeten edhe

emrat e Alexis Ballot-Beaupré, Clément Moras, Manuel-Achille Baudouin, Alphonse Bard, Jean-Pierre Manau dhe pjesëtarëve të trupit gjykues të Dhomave të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, të cilët, më 12 korrik 1906, sollën vendimin e pafajësisë së plotë të Alfred Dreyfus-it.

Të nderuar gjyqtarë të trupit gjykues,

Më 22 dhjetor 1894 Alfred Dreyfus u dënua me burg të përjetshëm, për tradhti të lartë. Pas mbajtjes në burg 4 vjet e 4 muaj. Reagimet e personaliteteve të shumta intelektuale patën ndikim të madh dhe detyruan gjykatë ushtarake që më 9 shtator 1899 të “gjejë rrethana lehtësuese dhe të ulë dënimin në 10 vjet burg”. Mirëpo ulja e dënimit nuk e uli revoltën e opinionit publik francez për këtë padrejtësi. Dhjetë ditë më vonë, Presidenti i atëhershëm Republikës së Francës, Émile Loubet, shpalli faljen për Alfred Dreyfus-in dhe e liroi nga burgu. Por falja nuk e fshinte dënimin! U dashtë të kalonin 12 vjet, që më në fund Dhomat e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Francës të shpallnin pafajësinë e plotë të Alfred Dreyfus-it

Të nderuar gjyqtarë të trupit gjykues,

Opinion i publik shqiptar dhe personalitete të shquara anekënd globit tokësor janë në dijeni për faktin se Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit qe 5 vjet e 8 muaj mbahen padrejtësisht prapa grilave. Zyra e Prokurorit të Specializuar, mbi bazën e akuzave të sajua nga Shërbimi Sekret i Serbisë, që ka qenë palë ndërlyftuese me

Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ka kërkuar dënim prej 45 vjetësh për secilin prej tyre, që me fjalë të tjera, është burg i përjetshëm! Procesi gjyqësor që jeni duke e drejtuar, është i një rëndësie historike që tejkalon përmasat e “Çështjes Dreyfus”.

Cili do qoftë vendimi juaj, ju do të mbeteni në kujtesën e njerëzimit.

Sa më përket mua, deri në shpalljen e vendimit, mbes me shpresë se shtyllën kryesore të akuzës që pretendon se të akuzuarit e lartpërmendur kanë qenë drejtues të një “Ndërmarrjeje kriminale të përbashkët që ka synuar vendosjen e pushtetit të tyre politik dhe kontrollin mbi tërë territorin e Kosovës”, do të keni parasysh jurisprudencën ndërkombëtare për këtë çështje.

Jurisprudenca e Gjykatës Speciale të Sierra Leones, e themeluar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së me Rezolutën 13151, të datës 14 gusht 2000, duhej të gjykonte krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet e rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, që ishin bërë në këtë shtet që nga muaji nëntor 1996. Mirëpo në aktvendimin përfundimtar, gjykata hodhi poshtë pretendimet e prokurorit për t’i cilësuar kryengritësit si pjesëtarë të një “Ndërmarrjeje kriminale të përbashkët” dhe solli vendimin se, “sipas statutit të gjykatës, marrja e pushtetit politik dhe vendosja e kontrollit mbi tërë territorin e Sierra Leones, sidomos në zonat ku ishin minierat e diamantit, nuk përbën qëllim kriminal sipas statutit të Gjykatës Ndërkombëtare. Në të Drejtën Ndërkombëtare nuk ekziston asnjë normë që ndalon kryengritjen”

(<https://www.refworld.org/jurisprudence/caselaw/scsl/2007/en/91904>, f. 40 dhe f. 67.)

Edhe në rastin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, kemi të njëjtën akuzë.

Përderisa projekti politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte çlirimi i vendit nga Serbia dhe krijimi i një shteti demokratik, propaganda e regjimit të Sllobodan Millosheviqit përpiquej ta prezantonte luftën çlirimtare të UÇK-së si projekt kriminal.

Megjithëse Carla Del Ponte ishte në dijeni të rrjedhave të procesit gjyqësor në Gjykatën Speciale të Sierra Leones dhe të dështimit të plotë që përjetoi prokurori, i cili u përpoq të përdorte konceptin “Ndërmarrje kriminale e përbashkët” në aktakuzën kundër kryengritësve të Këshillit Revolucionar të Forcave të Armatosura në atë shtet, ajo nuk

mori parasysh jurisprudencën e kësaj gjykate. Në aktakuzat kundër Fatmir Limajt, Haradin Balajt dhe Isak Musliut (2003) dhe atë kundër Ramush Haradinajt, Lahi Brahimajt dhe Idriz Balajt (2005) përdori terminologjinë “Ndërmarrje kriminale e përbashkët” që ishte sajuar nga Shërbimi Sekret i Serbisë në funksion të shtrembërimit të qëllimit politik të luftës çlirimtare, Mirëpo përpjekja e saj për të kriminalizuar luftën tonë dështoi, sepse: në të dy proceset gjyqësore të lartpërmendura, në vendimet përfundimtare gjykata shpalli pafajësinë e plotë të Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt dhe hodhi poshtë si të pabazuar pretendimin për ta prezantuar UÇK-në si “Ndërmarrje kriminale e përbashkët”.

Duke u mbështetur në këto vendime të jurisprudencës së gjykatave të lartpërmendura, kam bindjen e plotë se juristë me një integritet etik profesional do të hedhin poshtë si të pabaza pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për gjoja “Ndërmarrjen kriminale të përbashkët” të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar gjyqtarë të trupit gjykues,

Përveç vendimeve të gjykatave të lartpërmendura, jurisprudencë që nuk mund ta shmangë asnjë jurist, ju jeni dëshmitarë se në procesin gjyqësor që drejtoni ju erdhën të dëshmojnë personalitete të shquara me kredibilitet ndërkombëtare. Dëshmitë e James Rubin-it, Paul Williams-it, John Duncan-it, Jack Covey-it, Christopher Hill-it, Michael Durkee-s dhe Wesley Clark-ut do të mbeten në kujtesën e njerëzimit si përpjekje maksimale për të ndihmuar Dhomat e Specializuara të Kosovës të mos bëjnë gabim të dënojnë njerëz tërësisht të pafajshëm.

Është në ndërgjegjen tuaj drejtimi që do t’i jepni vendimit në procesin gjyqësor që do të mbetet në analet e historisë. Duke shpallur pafajësinë e plotë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në këtë proces gjyqësor të një rëndësie historike, ju do të mbeteni në kujtesën e njerëzimit në të njëjtën cilësi si të pjesëtarëve të trupit gjykues të Dhomave të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Francës, të cilët, më 12 korrik 1906, sollën vendimin për pafajësinë e plotë të Alfred Dreyfus-it.

Me respekt
Bardhyl Mahmuti
(Politolog dhe shkrimtar)

Zvicër, Vevey, 12 korrik 2026

Komandanti i FSK-së takon përfaqësuesit gjermanë, flasin për sigurinë

PRISHTINË, 13 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim zëvendësambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Böttcher, si dhe Tilmann Scherf nga Zyra e Jashtme Federale Gjermane. Gjatë takimit gjenerallejtënant Jashari e falënderoi delegacionin gjerman për mbështetjen e vazhdueshme që

Republika Federale e Gjermanisë i ka dhënë Kosovës, me theks të veçantë në ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që nga themelimi i saj. Sipas njoftimit, në takim u diskutua për zhvillimet aktuale në FSK, prioritetet dhe nevojat e saj, si dhe procesin e planifikimit për të ardhmen. Palët shkëmbyen pikëpamje lidhur me situatën e sigurisë dhe rëndësinë e bashkëpunimit

e partneritetit për përballimin e sfidave të përbashkëta. Në përfundim të takimit, gjenerallejtënant Jashari shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë në të gjitha fazat e zhvillimit të FSK-së, ndërsa të dyja palët u pajtuan për rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve bilaterale ushtarake ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë.



MBI 300 MIJË TURISTË BRENDË PESË MUAJVE NË KOSOVË

PRISHTINË, 13 KORRIK - Brenda pesë muajve të parë të vitit Kosova i ka pritur gjithsej 306 mijë e 447 vizitorë të huaj, prej tyre më së shumti janë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra dhe Turqia. Kurse qytetet që frekuentohen më së shumti janë Prizreni, Prishtina, Peja dhe Gjakova. Sipas përgjigjeve me shkrim të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, Prizreni kryeson listën e vendeve më të dëshiruara për të huajt, Prishtina mbetet pika kryesore hyrëse për turistët ndërkombëtarë, Peja vazhdon të jetë një nga qendrat kryesore të turizmit malor e aventurës, për të përfunduar në Gjakovën e njohur për Çarshinë e Madhe. “Destinacionet dhe qytetet më të vizituara nga turistët e huaj në Kosovë janë: Prizren - Destinacioni më i njohur turistik, i vizituar për qendrën historike, kalanë, xhamitë, kishat, festivalin DokuFest dhe trashëgiminë kulturore etj. Prishtina - kryeqyteti është pika kryesore hyrëse për turistët ndërkombëtarë. Atraksionet përfshijnë Monumenti NEWBORN, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Katedralja Shën Nënë Tereza etj. Peja - një nga qendrat kryesore të turizmit malor dhe aventurës. Vizitorët tërhiqen nga Gryka e Rugovës, Ujëvara e Drinit të Bardhë dhe Patriarkana e Pejës etj. Gjakova - e njohur për Çarshia e Madhe, arkitekturën tradicionale dhe trashëgiminë kulturore etj”, thuhet në përgjigjet e ministrisë, raporton Kosovapress. Kjo ministri potencon se rajoni i Prishtinës dhe i Pejës regjistrojnë numrin më të madh të vizitorëve



të huaj. “Sipas të dhënave të Agjencia e Statistikave të Kosovës, rajonet e Prishtinës dhe Pejës regjistrojnë numrin më të madh të vizitorëve dhe net-qëndrimeve turistike, ndërsa Prizren mbetet destinacioni më i njohur për turizmin kulturor”, thuhet në përgjigje. Udhërrëfyesi turistik Muhamer

Hasani tha se turistëve u pëlqen pothuajse gjithçka në Kosovë edhe pse shton se fillimisht kanë një lloj paragjykimi për shkak të keqinformimit. Sipas tij, turistët brenda pak kohësh e shohin një realitet tjetër dhe kuptojnë se janë keqinformuar për Kosovën nga vendet fqinje që i kanë vizituar më parë. “Një prej

pyetjeve të para e cila bëhet është siguria, pastaj është çështja e raporteve të Kosovës me vendet e tjera fqinje. Mirëpo, në këtë rast brenda disa minutave, mos të thonë sekonda se ndoshta e ekzagjeroj shihet se nuk ka të bëjë asgjë me atë se çfarë kanë dëgjuar ose se çfarë iu është rekomanduar atyre. Sepse

fatkeqësisht nganjëherë, kur musafirët vijnë në Kosovë, nëse veç i kanë vizituar disa prej vendeve fqinje, zakonisht tek ato vendet fqinje kanë me keqinformu për sigurinë në Kosovë. Tash është edhe shumë e thjeshtë për me e bë njëfarë demantimi të tillë, sepse në vitin 2000 domethënë në vitet e kaluara prej organizatave kredibile ndërkombëtare, Kosova është ranguar si njëra prej vendeve më të sigurta me u vizitu”, shtoi guida turistike. Ai theksoi se gati të gjitha nacionalitetet vijnë e vizitojnë Kosovën, duke konsideruar si më të veçantë faktin se po shtohen turistët nga Greqia dhe Rumania, që deri vonë ishin në numër të vogël. Ndërsa kryetari i Unionit të Turizmit të Kosovës, Baki Hoti, tha se rritja e turistëve në Kosovë është mjaft pozitive. Siç tha ai, një turist në Kosovë brenda 24 orëve shpenzon rreth 150 euro e, sipas tij, industria e turizmit është ajo që ndikon në ekonominë e vendit. Në vazhdimësi potencohet që Kosova ka potencial për turizmin, derisa i bëhet thirrje qeverisë për më shumë investime. Përndryshe, sipas ministrisë, turistët nga Shqipëria vijnë për shkak të afërsisë gjeografike, lidhjeve familjare dhe kulturore, derisa nga Gjermania një pjesë e madhe janë diaspora dhe vizitorë për biznes. Edhe nga Zvicra janë kryesisht diasporë kosovare dhe vizitorë të lidhur me familjet. Kurse vizitorët nga Turqia vijnë për turizëm kulturor, biznes dhe lidhje historike.

Pjesëtarët e FSK-së përfundojnë trajnimin e zhytjes në Shqipëri

PRISHTINË, 13 KORRIK - Në kuadër të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Qendra Ndërkombëtare e Trajnimeve për Kërkim-Shpëtim e Gardës Kombëtare të FSK-së ka realizuar trajnimin “Zhytje rifreskuese” në Qendrën Kombëtare të

Polumbarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Pashaliman, Vlorë. Trajnimi kishte për qëllim rifreskimin dhe avancimin e njohurive profesionale në zhytje, me fokus në teknikat moderne të zhytjes, sigurinë nënujore, planifikimin dhe realizimin e operacioneve të zhytjes,

kontrollin e lundrueshmërisë, sistemin buddy, si dhe zhvillimin e aftësive për mësimdhënie dhe demonstrim praktik. Përmes këtij programi pjesëtarët e FSK-së kanë forcuar kapacitetet profesionale për realizimin e misioneve të kërkim-shpëtimin dhe operacioneve të specializuara nënujore.



AKB dhe Oda e Përmbauesve Privatë thellojnë bashkëpunimin për forcimin e sigurisë juridike dhe mbështetjen e klimës së biznesit

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Odës së Përmbauesve Privatë të Kosovës, Mehdi Reshani, së bashku me bashkëpunëtorë. Takimi u zhvillua në frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, ku u diskutuan çështje me rëndësi për funksionimin e sistemit juridik në Kosovë, me theks të veçantë në efikasitetin e procedurave përmbaimore, zbatimin e vendimeve gjyqësore

dhe ndikimin e tyre në sigurinë juridike dhe zhvillimin ekonomik. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, theksoi se siguria juridike është një ndër parakushtet kryesore për një ekonomi të fortë dhe tërheqjen e investimeve. “Bizneset kanë nevojë për një sistem drejtësie dhe përmbaimit të besueshëm, efikas dhe të paanshëm. Zbatimi në kohë i vendimeve gjyqësore rrit besimin e investitorëve, mbron të drejtat e kreditorëve dhe forcon sundimin

e ligjit. AKB mbetet e përkushtuar të bashkëpunojë me të gjitha institucionet që kontribuojnë në përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë”, ka thënë Shahini. Kryetari i Odës së Përmbauesve Privatë të Kosovës, Mehdi Reshani, vlerësoi bashkëpunimin me AKB-në dhe theksoi rëndësinë e përmbaimit në funksionimin e shtetit ligjor. “Përmbauesit privatë janë një hallkë e rëndësishme në zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe garantimin e sigurisë



juridike. Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit është thelbësor për t'i identifikuar sfidat dhe për të ndërtuar mekanizma më efikas që u shërbejnë qytetarëve dhe ekonomisë së vendit”, u shpreh Reshani. Në përfundim të takimit, të dy kryetarët u pajtuan ta rritin

bashkëpunimin institucional përmes aktiviteteve dhe tryezave të përbashkëta profesionale, me synim avancimin e sigurisë juridike, rritjen e efikasitetit të sistemit të përmbaimit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe investimeve në Republikën e Kosovës.

INFLACIONI NË KOSOVË ARRIN 6 PËR QIND NË QERSHOR

PRISHTINË, 13 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin qershor 2026, sipas të cilit, inflacioni vjetor ka arritur 6 për qind, ndërsa në bazë mujore është regjistruar një rënie prej 0,1-përqindësh. Sipas ASK-së, indeksi i përgjithshëm i çmimeve të konsumit në qershor 2026 ishte 6 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



Rritja vjetore e çmimeve është ndikuar kryesisht nga shtrenjtimi i transportit (13,7 %), strehimit, ujit, energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve të tjera djegëse (11,1 %), pijeve alkoolike, duhanit dhe narkotikëve (5,1 %),

restoranteve dhe shërbimeve të akomodimit (4,5 %), shëndetësisë (4,1 %) dhe ushqimeve e pijeve joalkoolike (3,9 %). Po ashtu, rritje është regjistruar edhe te kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallrat e shërbimet e ndryshme (3,2 %), mobiljet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinore e shtëpisë (3 %), veshjet dhe këpucët (2,3 %), rekreacioni, sporti dhe kultura (2 %), si dhe informacioni dhe komunikimi (0,2 %). Në anën tjetër, rënie vjetore e

çmimeve është shënuar vetëm te grupi i shërbimeve arsimore, me 0,6 për qind. Krahasuar me muajin maj 2026, indeksi i çmimeve të konsumit ka shënuar një rënie mesatare prej 0,1-përqindësh. Kjo është ndikuar kryesisht nga ulja e çmimeve të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike (-0,6 %) si dhe të strehimit, ujit, energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve të tjera djegëse (-0,3 %). Ndërkohë, në baza mujore janë shënuar rritje të çmimeve në rekreacion, sport dhe kulturë

(0,8 %), shërbimet arsimore (0,5 %), kujdesin personal, mbrojtjen sociale dhe mallrat e shërbimet e ndryshme (0,4 %), transport (0,3 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (0,2 %), mobilje dhe pajisje shtëpiake (0,2 %), restorante dhe shërbime akomodimi (0,2 %), veshje dhe këpucë (0,1 %) si dhe shëndetësi (0,1 %). ASK-ja ka bërë me dije se të dhënat janë përpiluar sipas klasifikimit të ri COICOP 2018, me vit bazë 2025 = 100 dhe metodologji të përditësuar.

ODA EKONOMIKE AMERIKANE KËRKON QË GAZI AMERIKAN TË JETË PRIORITET I INSTITUCIONEVE TË REJA

PRISHTINË, 13 KORRIK - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u ka bërë thirrje institucioneve të reja që qasjen e Kosovës në infrastrukturën rajonale të gazit të lëngshëm natyror (LNG) amerikan, ta trajtojnë si prioritet në kuadër të politikave të ardhshme energjetike të vendit. Në një njoftim të publikuar të hënën, Oda Amerikane ka vlerësuar se Kosova ndodhet në një moment të rëndësishëm për të ardhmen e sektorit energjetik, ndërsa vendimet e ardhshme do të ndikojnë në sigurinë energjetike, zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë e vendit. “Me konstituimin e Kuvendit të

Republikës së Kosovës dhe zgjedhjen e institucioneve të reja, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u bën thirrje bartësve të mandatit të ri institucional që përfshirjen e Kosovës në infrastrukturën rajonale të gazit të lëngshëm natyror amerikan (LNG) ta trajtojnë me prioritet dhe ta shqyrtojnë seriozisht si pjesë të politikës së ardhshme energjetike të vendit”, thuhet në njoftim. Sipas Odës Amerikane, Kosova vazhdon të përballë me sfida në sektorin energjetik për shkak të kapaciteteve të vjetruara prodhuese dhe varësisë nga importi i energjisë elektrike. “Çdo vit vonesë në krijimin e



kapaciteteve të reja vendore nënkupton ekspozim të vazhdueshëm ndaj paqëndrueshmërisë së tregjeve rajonale, kostove të larta të importit dhe pasigurisë së

furnizimit”, thuhet më tej në deklaratë. Oda Ekonomike Amerikane konsideron se përfshirja në infrastrukturën rajonale të LNG-së mund të kontribuojë në

diversifikimin e burimeve të energjisë, rritjen e fleksibilitetit të sistemit elektroenergjetik dhe integrimin më efikas të burimeve të ripërtëritshme. “Përfshirja e Kosovës në infrastrukturën rajonale të LNG-së amerikane meriton një vlerësim të veçantë”, thekson Oda, duke shtuar se kjo mundësi krijon bazë për zhvillimin e kapaciteteve të reja energjetike dhe sigurimin e financimit për projekte strategjike. Në fund, Oda Amerikane ka kërkuar që institucionet e reja të ndërtojnë politika energjetike të bazuara në analiza profesionale dhe në interesin afatgjatë të Kosovës.

Rreth 14 mijë euro gjoba ndaj mjeteve të rënda, Basha paralajmëron kontrolle të rrepta në rrugë

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar se do t'i vazhdojë kontrollet ndaj operatorëve dhe ngasësve të mjeteve të rënda, me qëllim parandalimin e dëmtimit të infrastrukturës rrugore. Ministri në detyrë, Dimal Basha, ka bërë me dije se një nga shkaqet kryesore të dëmtimit të rrugëve është

qarkullimi i mjeteve të rënda të mbingarkuara të cilat tejkalojnë kufijtë e lejuar të peshës. Sipas tij, gjatë sezonit veror, për shkak të temperaturave të larta, rreziku i dëmtimit të asfaltit rritet, prandaj kërkohet respektim më i madh i kufizimeve nga operatorët dhe drejtuesit e mjeteve të rënda. “Si Ministri e Infrastrukturës dhe

Transportit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do të jemi vazhdimisht në terren, duke zhvilluar kontrolle të rrepta për të parandaluar dëmtimin e infrastrukturës rrugore”, ka deklaruar Basha. Sipas njoftimit, vetëm më 1 korrik 2026 janë shqiptuar 24 kundërvajtje ndaj mjeteve që kanë tejkaluar peshën e lejuar, me vlerë totale prej 13 mijë e

910 eurosh. Nga kjo shumë, 13 mijë e 140 euro gjoba janë shqiptuar ndaj operatorëve ekonomikë, ndërsa 770 euro ndaj personave fizikë. Ministria ka bërë me dije se kontrollet do të vazhdojnë dhe se nuk do të ketë tolerancë ndaj rasteve të mbingarkesës, të cilat, sipas saj, rrezikojnë sigurinë në komunikacion dhe



dëmtojnë rrugët e ndërtuara me paratë e qytetarëve.

JOSCHKA FISCHER: ME AFD-në NË PUSHTET, EVROPA RREZIKON TË HUMBASË TË ARDHMEN



Ish-ministri i Jashtëm gjerman Joschka Fischer paralajmëron se Gjermania ndodhet përballë një zgjedhjeje historike.

Ai thotë se vendi duhet të vendosë mes një rruge nacionaliste dhe një rruge evropiane. Sipas tij, modeli evropian i ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore i ka sjellë Gjermanisë paqe dhe zhvillim. Fischer shpreh shqetësimin se rritja e partisë AfD përbën rrezik për demokracinë gjermane dhe për Bashkimin Evropian.

Fischer mbështet forcimin e mbrojtjes evropiane, por kërkon që riarmatimi i Gjermanisë të zhvillohet si pjesë e një projekti të përbashkët evropian. Sipas tij, vetëm bashkëpunimi mes vendeve kryesore evropiane mund të garantojë stabilitet dhe siguri. Në këtë intervistë ai analizon të ardhmen e Gjermanisë, të Bashkimit Evropian dhe marrëdhëniet me Rusinë.

Study Suggests Amygdala Response Can Predict Depression Treatment OutcomesKeep Watching

Pyetje: Në librin tuaj të ri pyesni: “Kush jemi ne?”. Pse është kaq e rëndësishme kjo pyetje?

Joschka Fischer: Gjermania duhet të diskutojë seriozisht se kush është dhe çfarë roli duhet të ketë në

Europë. Ne kemi përpara dy rrugë: një Gjermani nacionaliste, që do të ishte një rrezik për kontinentin, ose një Gjermani evropiane, si ajo që ndërtoi Konrad Adenauer dhe që solli mbi 70 vjet paqe dhe mirëqenie.

Pyetje: Madeleine Albright ju tha dikur: “Joschka, ti je shumë gjerman”. Kishte të drejtë?

Joschka Fischer: Po. Kam lindur dhe jam rritur në Gjermani. Gjuha, kultura dhe mënyra ime e të menduarit janë gjermane. Gjermania është atdheu im, por historia e saj e bën këtë lidhje të ndërlikuar dhe të mbushur me ndjenja të përziera.

Pyetje: Çfarë ju bën të ndiheni në siklet kur flisni për Gjermaninë?

Joschka Fischer: Trashëgimia historike. Nacionalizmi gjerman solli katastrofa të mëdha në Europë. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore dhe me mbështetjen amerikane Gjermania u bë një demokraci evropiane dhe rifitoi besimin e fqinjëve.

Pyetje: Si e shihni situatën e sotme?

Joschka Fischer: Amerika po tërhiqet gradualisht nga Europa. Kjo e bën kontinentin më të pasigurt dhe rrezikon rikthimin e nacionalizmave. Për Gjermaninë ky është një rrezik edhe më i

madh për shkak të historisë së saj.

Pyetje: A ekziston rreziku që Gjermania të rikthehet në një situatë të ngjashme me Republikën e Vajmarit?

Joschka Fischer: Jo në të njëjtën formë. Por ekziston rreziku që lidhjet mes vendeve evropiane të dobësohen dhe secili shtet të ndjekë interesat e veta kombëtare. Për Gjermaninë kjo do të ishte shumë e rrezikshme.

Pyetje: Ju shkruani se bashkimi i Gjermanisë nuk u shoqërua me një debat për identitetin kombëtar. Çfarë nënkuptoni?

Joschka Fischer: U fol vetëm për ekonomi, para dhe infrastrukturë. Nuk u ndërtua një rrëfim i përbashkët kombëtar. Nuk u diskutua pyetja “Kush jemi ne?”. Ky boshllëk u shfrytëzua më vonë nga e djathta.

Pyetje: Si mund të bindet Gjermania Lindore të mos ndjekë rrugën e nacionalizmit?

Joschka Fischer: Kjo kërkon kohë. Nevojiten breza të rinj që të rriten me frymën evropiane dhe me programe si Erasmus. Po ashtu duhet të zvogëlohen dallimet ekonomike mes Lindjes dhe Perëndimit.

Pyetje: A ju shqetëson mundësia që AfD të hyjë në qeverinë federale?

Joschka Fischer: Po. Do të ishte një goditje për demokracinë gjermane. Besimi i vendeve të tjera ndaj Gjermanisë do të binte ndjeshëm. Nëse AfD do të qeveriste vendin më të madh të Bashkimit Evropian, e ardhmja e BE-së do të vihej seriozisht në rrezik.

Pyetje: Çfarë pasojash do të kishte kjo për Europën?

Joschka Fischer: Marrëdhëniet me Francën dhe Italinë do të përkeqësoheshin. Pa bashkëpunimin franko-gjerman nuk mund të ekzistojë një Europë e fortë.

Pyetje: Gjermania po investon shumë në forcimin e ushtrisë. A ju shqetëson kjo?

Joschka Fischer: Riarmatimi është i domosdoshëm, por nuk duhet të jetë vetëm një projekt gjerman. Ai duhet të bëhet pjesë e një projekti evropian të mbrojtjes, me struktura të përbashkëta dhe vendim-marrje të përbashkëta.

Pyetje: A rrezikon NATO të dobësohet?

Joschka Fischer: Nëse Shtetet e Bashkuara largohen, evropianët duhet të ndërtojnë një shtyllë më të fortë evropiane brenda NATO-s dhe të forcojnë bashkëpunimin në mbrojtje.

Pyetje: Në librin tuaj thoni se administrata Trump dëshiron një

ndryshim politik nacionalist në Europë. Pse?

Joschka Fischer: Kjo është ajo që dëshirojnë mbështetësit e lëvizjes MAGA. Fjalimi i zëvendëspresidentit amerikan në Mynih tregoi qartë këtë drejtim politik.

Pyetje: Ju mendojnë se Italia duhet të ketë një rol më të madh në mbrojtjen evropiane?

Joschka Fischer: Po. Italia është një vend i rëndësishëm në aspektin strategjik, politik dhe teknologjik. Ajo duhet të jetë pjesë e udhëheqjes evropiane në çështjet e sigurisë.

Pyetje: A mund të kenë ende besim vendet e tjera tek Gjermania?

Joschka Fischer: Besimi duhet ruajtur me shumë kujdes. Pas Luftës së Dytë Botërore Gjermania e fitoi këtë besim me përpjekje të mëdha. Një qeveri me AfD do ta vinte seriozisht në rrezik këtë arritje.

Pyetje: A duhet të negociohet me Vladimir Putinin?

Joschka Fischer: Dialogu është gjithmonë i mundur, por vetëm nëse Rusia heq dorë nga kërkesat maksimaliste dhe ndalet dhuna. Nuk mund të ketë negociata serioze ndërsa vazhdon agresioni ndaj Ukrainës.

[Intervistë për Paolo Valentino, Corriera Della Sera](#)

NËSE SOKRATI DO TË KISHTE LLOGARI TIKTOK-u?



Çfarë do të ndodhte nëse Sokrati, filozofi që ndryshoi mënyrën se si njerëzit mendojnë do të jetonte në epokën e rrjeteve sociale? Imagjinoni për një moment sikur Sokrati zgjohet në vitin 2026. Në vend të agorasë së Athinës, ai gjen një botë të mbushur me telefona inteligjentë, video tridhjetësekondëshe dhe algoritme që vendosin çdo ditë se çfarë do të shohin miliarda njerëz. Në vend të diskutimeve në shesh, njerëzit debatojnë, komentojnë e shajnë në komente. Në vend të nxënësve që ecin pranë tij, miliona përdorues lëvizin gishtin mbi ekran, duke kaluar nga një video te tjetra brenda pak sekondash. Pyetja tingëllon si një lojë e mendjes, por në të vërtetë na ndihmon të kuptojmë diçka shumë më të rëndësishme: a do të kishte vend filozofia e Sokratit në një epokë të dominuar nga shpejtësia, opinioni i menjëhershëm dhe kërkimi i vazhdueshëm për vëmendje? Përgjigjja nuk është aq e thjeshtë sa mund të duket.

Sokrati nuk ishte krijues përmbajtjeje

Nëse do ta gjykonim me standardet e sotme, Sokrati do të ishte një krijues përmbajtjeje

shumë i pazakontë. Ai nuk shkroi libra dhe nuk la traktate. Nuk hartoi një sistem filozofik të përfunduar. Madje nuk pretendonte se kishte përgjigje për gjithçka. Gjithçka që dimë për të vjen kryesisht nga nxënësit e tij, sidomos nga Platoni. Por ajo që e bëri të pavdekshëm nuk ishte një teori, por një mënyrë e të menduarit. Në një kohë kur sofistët udhëtonin nga qyteti në qytet duke mësuar njerëzit si të fitonin debatet, Sokrati nuk ishte i interesuar të fitonte. Ai ishte i interesuar të zbulonte nëse një ide qëndronte në këmbë kur vihej në provë. Në këtë kuptim, ai nuk do ta përdorte TikTok-un për të bindur njerëzit se kishte të drejtë. Do ta përdorte për t'i detyruar të mendonin nëse ishin të sigurt për atë që besonin.

Epoka e përgjigjeve kundër epokës së pyetjeve

Rrjetet sociale funksionojnë mbi një logjikë të thjeshtë: përgjigjet e shpejta shpërblehen. Titujt absolutë, deklaratat e forta dhe bindja e palëkundur tërheqin më shumë vëmendje sesa dyshimi. Video që fillojnë me “Ja e vërteta...” ose “Këto janë pesë rreg-

ullat që duhet të ndjekësh...” kanë më shumë gjasa t’i bëjnë përdoruesit të ndalen, sesa një video që nis me pyetjen: “Po sikur të jemi duke gabuar?” Dhe Sokrati do të zgjidhte pikërisht këtë të dytën. Metoda e tij nuk bazohej te përgjigjja, por te pyetja. Ai besonte se njohuria nuk mund të imponohej nga jashtë. Ajo lindte kur njeriu zbulonte vetë kontradiktat e mendimit të tij. Kjo metodë, e njohur sot si metoda sokratike, nuk kishte si qëllim ta poshtëronte bashkëbiseduesin. Qëllimi ishte ta çlironte nga iluzioni se kishte kuptuar diçka vetëm sepse e kishte dëgjuar shumë herë. Algoritmet duan siguri, kurse filozofia fillon me dyshimin. Një nga paradokset më interesante të kohës sonë është se algoritmet priren të promovojnë përmbajtje që shpreh bindje të forta. Sa më kategorike të jetë një deklaratë, aq më shumë reagime prodhon. Por Sokrati ishte i famshëm pikërisht sepse vinte në dyshim sigurinë. Kur dikush pretendonte se e dinte çfarë ishte drejtësia, guximi apo lumturia, ai nuk e kundërshtonte menjëherë. Fillonte të bënte pyetje. Pas disa minutash dialogu, bashkëbiseduesi kuptonte se përkufizimi i tij kishte boshllëqe, ose kundërthënie. Me siguri, ne që jetojmë në

epokën e të gjithëditurve, Sokrati do të na kujtonte se pranimi i mosdijes nuk është dobësi. Është pika nga e cila fillon të menduarit. A do të bëhej viral? Ndoshta po. Por jo për arsye që mendojmë ne. Nuk do të ishte viral sepse jepte këshilla motivuese apo sekrete suksesi. Do të ishte viral sepse do të vinte në siklet njerëzit që flisnin me siguri të tepruar. Një debat me një figurë publike mund të niste me një pyetje të zakonshme dhe të përfundonte me një heshtje të gjatë, kur bëhej e qartë se termat e përdorur nuk ishin menduar kurrë me kujdes. Pikërisht për këtë arsye ai kishte kaq shumë kundërshtarë edhe në Athinë. Ai nuk sulmonte njerëzit. Sulmonte bindjet e pakontrolluara.

Problemi nuk është TikTok-u

Do të ishte e lehtë të fajësonim teknologjinë për gjithçka. Por kjo nuk do të ishte një qasje sokratike. Sokrati nuk do të pyeste nëse TikTok-u është i mirë apo i keq. Ai do të pyeste si e përdorim atë. Një platformë mund të shërbejë për sipërfaqësi, por mund të shërbejë edhe për të ndezur kureshtjen. Një video tridhjetësekondëshe nuk mund të

zëvendësojë një dialog filozofik, por mund të bëhet shkëndija që e nis atë. Në fund të fundit, edhe vetë Sokrati nuk kërkonte turma të mëdha. Atij i mjaftonte një njeri që ishte i gatshëm të mendonte seriozisht.

Një mësim

Ndoshta pyetja “Si do ta përdorte Sokrati TikTok-un?” nuk ka një përgjigje të vetme. Por ajo na ndihmon të kuptojmë diçka thelbësore për kohën tonë. Jetojmë në një epokë ku informacioni është më i bollshëm se kurrë, por reflektimi duket gjithnjë e më i rrallë. Nuk na mungojnë përgjigjet; na mungojnë pyetjet e mira. Nëse Sokrati do të kishte një llogari në TikTok, ndoshta nuk do të ishte influenceri më i ndjekur. Mund të mos fitonte as garën e algoritmeve. Por çdo video e tij do të kishte një efekt që shumë përmbajtje virale nuk e arrijnë: do ta linte shikuesin me një shqetësim të dobishëm, me dyshimin se ndoshta ajo që e kishte marrë për të mirëqenë nuk ishte aq e sigurt sa mendonte. Dhe ndoshta ky është mësimi më i madh që Sokrati do të sillte edhe në epokën e rrjeteve sociale: përparimi nuk fillon kur gjejmë përgjigjen e duhur, por kur kemi guximin të bëjmë pyetjen e duhur. / bota.al

EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Montim
Servisim
Parket



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Zyrtare: Manchester Unitedi paraqet Andrey Santosin

PRISHTINË, 13 KORRIK - Manchester Unitedi ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit brazilian Andrey Santos nga Chelsea. Klubi nga "Old Trafford" ka paguar 48 milionë funte, plus edhe dy milionë funte të tjera në formë bonusesh për t'i

siguruar shërbimet e 22-vjeçarit. Pas prezantimit si lojtar i ri i Manchester Unitedit, Santos nuk e fshehu emocionin për realizimin e një ëndrre të kahershme. "Që kur isha i vogël kam ëndërruar këtë moment. Historia dhe

përgjegjësia që vjen me këtë fanellë janë arsyeja pse jam këtu. Do ta shkruaj emrin tim në historinë e këtij klubi të madh", deklaroi Andrey Santos pas nënshkrimit të kontratës. Ndërkohë, Man Utd do të jetë aktiv edhe më tej në afatin

kalimtar veror ngaqë e ka kompletuar marrëveshjen për Youri Tielemans të Aston Villas. Unitedi edicionin tjetër synon të rikthehet në garë për titullin kampion pasi vitin e kaluar e siguroi pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve.



NGA FUSHAT ME BALTË TE SKENA MË E MADHE E BOTËS: 20 YJET E ANGLISË QË SHKRUAN HISTORINË NGA LIGAT E ULËTA

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kombëtarja e Anglisë është vetëm një hap larg finales së Kupës së Botës 2026, por rrugëtimi i shumicës së lojtarëve të Thomas Tuchel nuk ka nisur në stadiumet luksoze të Premierë Ligës.

Nga 26 futbollistët e grumbulluar për Botërorin, 20 prej tyre kanë luajtur më parë në ligat e ulëta angleze, ndërsa disa kanë kaluar edhe në futbollin gjysmëprofesionist përpara se të arrinin në skenën më të madhe të futbollit, shkruan "Telegrafi". Ky fakt tregon se rruga drejt majës nuk është gjithmonë e drejtpërdrejtë, pasi shumë prej yjeve aktualë të "Tre Luanëve" kanë kaluar vite duke luajtur në fusha modeste dhe në klube larg vëmendjes së publikut.

Portierët kaluan nga Liga Kombëtare deri te Botërori

Portieri titullar Jordan Pickford zhvilloi gjashtë huazime në nivele të ndryshme të futbollit anglez. Ai luajti në Ligën Kombëtare angleze (kategoria e pestë), Kategorinë e Katërt, Kategorinë e Tretë dhe Kategorinë e Dytë, përpara se të fitonte vendin te Sunderlandi dhe më pas të bëhej portieri numër një i Anglisë. Edhe Dean Henderson kaloi një rrugëtim të ngjashëm, duke



luajtur në Ligën Kombëtare angleze, Kategorinë e Katërt, Kategorinë e Tretë dhe Kategorinë e Dytë, ndërsa James Trafford u formua në Kategorinë e Tretë me Accrington Stanley dhe Bolton Wanderers përpara se të shpërthente te Burnley në Kategorinë e Dytë.

Nga Kategoria e Dytë drejt elitës

Mbrojtës si John Stones, Marc Guehi, Trevoh Chalobah, Ezri Konsa, Reece James, Djed Spence dhe Jarell Quansah kaluan fillimisht në Kategorinë e Dytë ose Kategorinë e Tretë, ku fituan

përvojën që më pas i çoi në klubet më të mëdha të Anglisë. Një nga historitë më frymëzuese është ajo e Dan Burn, i cili dikur punonte në supermarket për të siguruar të ardhura, ndërsa luante në Ligën Kombëtare angleze. Sot, në moshën 34-vjeçare, ai debuton në Kupën e Botës me Anglinë.

Edhe Kane, Bellingham dhe Watkins e nisën larg elitës

Kapiteni Harry Kane luajti fillimisht me Leyton Orient në Kategorinë e Tretë, ndërsa më pas me Millwall dhe Leicester

City në Kategorinë e Dytë, përpara se të shpërthente te Tottenham. Jude Bellingham bëri vetëm një sezon me Birmingham Cityn në Kategorinë e Dytë, por mjaftoi për të bindur Borussia Dortmundin ta transferonte. Ndërkohë Ollie Watkins luajti edhe në Ligën Kombëtare angleze, përpara se të bëhej pjesë e Kategorisë së Katërt, më pas të Kategorisë së Dytë dhe në fund të ngjitej në Ligën Premier.

Toney dhe Gordon kaluan periudha të vështira

Ivan Toney zhvilloi vite të tëra në

Kategorinë e Katërt dhe Kategorinë e Tretë me disa klube të ndryshme përpara se të shpërthente te Brentford në Kategorinë e Dytë dhe të fitonte një vend në kombëtaren angleze.

Edhe Anthony Gordon, tashmë pjesë e Barcelonës, pati një periudhë jo të suksesshme në Kategorinë e Dytë me Preston North End, ku humbi vendin në formacion pas ndërrimit të trajnerit.

Vetëm gjashtë lojtarë nuk kanë luajtur në ligat e ulëta angleze

Nga skuadra aktuale e Anglisë vetëm gjashtë futbollistë nuk kanë luajtur asnjëherë në ligat e ulëta të futbollit anglez: Nico O'Reilly, Declan Rice, Kobbie Mainoo, Bukayo Saka, Marcus Rashford dhe Noni Madueke (luajti në kategorinë e dytë të Holandës me ekipin rezervë të PSV-së, jo në Angli).

Rrugëtimi i kësaj gjenerate të Anglisë dëshmon se suksesi nuk vjen gjithmonë nga akademitë elitare apo debutimet e hershme në Premierë Ligë.

Për shumicën e lojtarëve të Thomas Tuchel rruga drejt gjysmëfinales së Kupës së Botës kaloi fillimisht nëpër baltën dhe sfidat e futbollit të ligave të ulëta angleze.

E papritur, Pep Guardiola merr drejtimin e Italisë?

PRISHTINË, 13 KORRIK - Pep Guardiola është shfaqur kandidat befasues për ta marrë drejtimin e Kombëtares së Italisë, edhe pse deri më tani Antonio Conte dhe Roberto Mancini konsideroheshin favoritët kryesorë për këtë post. Sipas raportimit të "La Gazzetta dello Sport", e


ardhmja e stilit të Italisë tashmë është në duart e drejtorëve të rinj teknikë, Paolo Maldini dhe Leonardo, të cilët pritet ta marrin vendimin për trajnerin e ardhshëm të "Azzurrëve". Megjithatë, raporti thekson se as Conte dhe as Mancini nuk janë në krye të listës së dëshirave të dy drejtuesve.

Në vend të tyre emri i Guardiols po fiton gjithnjë e më shumë terren. Ajo që në fillim dukej si një ide e pamundur, tashmë po shihet si një mundësi reale falë rrjetit të gjerë ndërkombëtar të Leonardos dhe aftësisë së tij për të bindur trajnerë të nivelit më të lartë.

Edhe pse kontrata e fundit e Guardiols me Manchester

Cityn i siguron rreth 25 milionë euro bruto në sezon, trajneri katalanas thuhet se gjithmonë u ka dhënë përparësi projekteve sportive mbi aspektin financiar.

Drejtimi i Kombëtares së Italisë dhe udhëheqja e rindërtimit të një prej kombëtareve më të mëdha në botë mund të jetë sfidë joshëse për të.





Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “FLEMINGO KOSOVO” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810126278 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “FLEMINGO KOSOVO” D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810126278 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “FLEMINGO KOSOVO” L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 810126278 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fis Rogova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl, 6-9 të sh.m.u. “Rudolf Walther” Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Adizo SH.PK. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Autoshkolla ARGJ ABC” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 811998337 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Autoshkolla ARGİ ABC” D.O.O. od Mitrovia, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811998337 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Autoshkolla ARGJ ABC” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811998337 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

